



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## BASHKIA VLORË

### NJOFTIM

Bashkia Vlorë njofton studentët që ndjekin studimet në vitin e parë në institucionet e larta arsimore publike se mund të përfitojnë bursë në rast se plotësojnë kriteret si studentë në nevojë :

Studentë në nevojë konsiderohen:

#### **I. Sipas kriterit ekonomik:**

- 1) Studentët që ndjekin studimet në largësinë mbi 10 (dhjetë) km nga vendbanimi i përhershëm i tyre, familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike nga njësia e vetëqeverisjes vendore;
- 2) Secili nga studentët, i cili rezulton bashkëshort me fëmijë, dhe kur familja e tij trajtohet me ndihmë ekonomike nga njësia e vetëqeverisjes vendore;
- 3) Studentët që janë persona me aftësi të kufizuara, të vërtetuar nga Komisioni Mjekësor i Kaktimit të Aftësisë për Punës, përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar.

#### **II. Jashtë kriterit ekonomik:**

- 1) Studentët që kanë përfituar statusin e jetimit;
- 2) Studentët që kanë humbur përgjegjësinë prindërore, me vendim gjykate të formës së prerë;
- 3) Studentët që janë identifikuar e trajtuar si viktime të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë humbur kujdesin prindëror;
- 4) Studentët që rezultojnë fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës.
- 5) Studentët e regjistruar në vitin e parë , në ciklin e parë të studimeve , **në programet e studimit në fushën e mësuesisë** , te cilët duhet të përmbushin kriterin e notës mesatare 9 ( nëntë ) deri në 10 ( dhjetë ) , e përlloritur si mesatare e notave të të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë, përfshirë edhe rezultatet e provimeve të Matures Shtetërore.

**Për sqarime të mëtejshme paraqituni pranë zyrës së arsimit në Bashki. Afati përfundimtar për dorëzimin e dokumentave është 16 Janar 2019.**